




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostuevat Prilbena/Prodato Received/Delivered	06-03-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SMS/ICK	2395/2023		117



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.112/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësi, ka shqyrtuar ankesën më numër A.nr.112/2023 të datës 23.01.2023, të parashtruar nga ankuesi nga Lipjani, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, me bazë ankimore "shkelje e së drejtës së pagës", duke vepruar sipas nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 03.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Approvohet si e bazuar* ankesa më numër A.nr.112/2023 e datës 23.01.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. *Obligohet* Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e mëditjes në vlerë prej pesëdhjetë (50) eurove, të ndalur nga paga ankuesit për muajin tetor 2022.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 23.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 665/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër ndalesës së mëditjes në shumën prej 50 Euro lidhur me pagën e muajit tetor 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa, me datë 31.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 665/2023 të datës 23.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 30.09.2022 nga S.A për A.G; Kërkesë për pushim mjekësor e datës 22.09.2022; Fletëlëshimin me Nr.amzës 5766/22 të lëshuar nga Klinika e Urologjisë; Raporti i ndërprerjes së përkohshme për punë i ankuesit i datës 20.09.2022; Vendimin me numër protokollit 37/KA i datës 29.12.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës; kopje e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 938/2023 të datës 26.01.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 1149/2023 të datës 31.01.2023; Kontratën e Punës për Kohë të Pacaktuar për ankuesin e datës 30.06.2020; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 03.10.2022; Listën e pagave për ankuesin për muajin tetor 2022.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën e punës Zyrtar Korrektues në Qendrën Korrektuese në Lipjan. I njëjti më datë 22.09.2022 ka plotësuar kërkesën për pushim mjekësor, në kohëzgjatje kohore nga data 10.09.2022 deri më datë 19.09.2022 (9 ditë pune), ndërsa, Mbikëqyrës i ankuesit përmes njoftimit të datës 30.09.2022 (i cili nuk përmban asnjë simbol zyrtar mbi identifikim e institucionit) ka njoftuar Drejtorin e QKLM, së ankuesi më datë 07.09.2022 ka lajmëruar që gjendet në pushim mjekësor, mirëpo, me rastin e kthimit nga pushimi më datë 19.09.2022 nuk ka ofruar dokumentacionin mjekësor për datat 07.09.2022, 08.09.2022 dhe 09.09.2022, duke propozuar që ankuesit ti ndalet mëditja nga pagë për këto tri ditë. Kurse bazuar në listën e pagave të muajit tetor 2022, ankuesit i është bërë një ndalesë në pagë në shumën prej pesëdhjetë (50) eurove.

Kundër ndalesës së mëditjes në fjalë, ankuesi më datë 22.12.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, i cili me Vendimin me numër protokollit 37/KA të datës 29.12.2022 është shpall jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 22.12.2022, duke e udhëzuar ankuesin që të parashtoj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ndalesa e mëditjes prej 50 Eurove është e kundërligjshme pasi që është bërë pa ndonjë vendim.

Bazuar në dispozitat e nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: *1. Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë...*, rrjedhë së nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *kushite të veçanta apo shitesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve*, rrjedhimisht Këshilli ka kompetencë lëndore për trajtimin e kësaj çështje administrative në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 16 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë gjegjësisht nenin 11 më të cilin është përcaktuar se: *Në rast sëmundje, apo paaftësie të përkohshme në punë, zyrtari publik duhet të informojë brenda ditës mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe paraqitje e arsytimit të mungesës me dëshminë e organit kompetent mjekësor. 2. Zyrtari publik ka të drejtë për pushim mjekësor në kohëzgjatje deri njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti me kompensim 100% të pagës. 3. Ditët e parapara për pushim mjekësor sipas paragrafit 2 të këtij neni, zyrtari publik me dëshminë e organit kompetent mjekësor mund ti shfrytëzoj pushim mjekësorë edhe në rast të sëmundjes të fëmijës së tij.... 5. Dëshmia e organit kompetent mjekësor sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni nënkupton dëshminë cila përcakton qartë ditët e mungesës në punë për shkak të gjendjes së tij mjekësore. Dëshmia duhet të mbroj te dhënat personale të zyrtarit publik sipas legjislacionit në fuqi...* andaj, ndërlidhur me këtë bazë ligjore si dhe duke u bazuar në provat e çështjes, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së ankuesi me datë 07.09.2022 kishte njoftuar mbikëqyrësin e tij lidhur me fillimin dhe arsyet e pushimit mjekësor, fakt i pohuar edhe nga vet mbikëqyrësi i ankuesit përmes njoftimit të datës 30.09.2022. Rrjedhimisht Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur së ankuesi kishte ofruar dëshmi nga organi kompetent mjekësorë i cili i referohet datave nga 07.09.2022 deri 09.09.2022 lidhur me trajtimin e prindit të ankuesit në Klinikën e Urologjisë të Shërbimit Spitalor, ndërsa, lidhur me datat 10.09.2022 deri 19.09.2022 ka ofruar dëshmi mjekësore përkatësisht Raport të Ndërprerjes së Përkohshme në Punë, mirëpo sipas kërkesës për pushim të datës 10.09.2022 ankuesit i janë njohur ditët e pushimit mjekësor vetëm për datat nga 10.09.2022 deri 19.09.2022.

Përkitazi me ligjshmërinë e ndaljes së mëditjes së ankuesit në vlerës prej 50 euro, Kolegji ka analizuar nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave, si dhe nenin 3 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e nëpunësve civil i aplikueshme në kohën e ndalesës së mëditjes e kundërshtuar me ankesë, ku theksohet se : *E drejta për marrjen e pagës së rregullt mund të pezullohet vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin e Shërbimit Civil. Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rrjedhë së paga e nëpunësit civil mund të ndalet vetëm mbi bazën e kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson së ndalesa e mëditjes prej 50 eurove, pa vendim të organit kompetent si dhe pa ndonjë informim të ankuesit është veprim i pabazuar ligjërisht dhe në kundërshtim të plot me parimin e ligjshmërisë të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku është përcaktuara se: *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj...'***

Po ashtu, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton së është detyrim ligjor i organit publik për të dhënë informacion dhe ndihmë aktive, ashtu që mosdija e palës të mos përkeqësoj mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit.

Bazuar në konstatimet si me lart, dhe me qëllim të kthimit të ligjshmërisë Kolegji vendosi që të aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.112/2023 e datës 23.01.2023, e parashtruar nga ankuesi , duke obliguar Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës që



brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e mëditjes në vlerë prej pesëdhjetë (50) eurove, të ndalur nga paga ankuesit për muajin tetor 2022.

Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr./L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.112/2023.

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.